



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË  
ZYRË E PËRMBARIMIT PRIVAT "QEVA"- SH.P.K



Nr. 303 / 3 Prot

Pogradec më 11.01.2021

**URDHËR**

***"PËR VËNIEN E SEKUESTROS KONSERVATIVE"***

**Drejtuar : Qendra Kombëtare e Biznesit, QKB**

**Adresa:** Bulevardi "Zhan D'ark", Prona Nr.33,

**TIRANË**

**Drejtuar Debitorit:** Shoqëria "FLORA KO" Shpk (FLORA CO), me NIPT J61804014I, me Ortak i vetëm e Administrator Z.Perlat Elezi.

**Adresa:** Rruga e Qelqit, Kombinat,

**TIRANË**

**Për dijeni Kreditorit : Shoqëria "INA 2004" shpk, me Administrator Stefan Çausi.**

**Adresa:** Tushemisht, Nj/Adm Buçimas,

**POGRADEC.**

Pranë Shoqërisë Zyrë e Përmbarimit Privat "QEVA"-Sh.p.k, Pogradec, me seli dhe adresë lagjia Nr.3,Rruga "Andon Xoxe", Pogradec, është regjistruar çështja përmbarimore me Nr. 303 rregj, regjistruar më datë 08.01.2021, e transferuar nga Shoqëria Përmbarimore Private "ALBASE" Sh.p.k, Tiranë, me vendimin e transferimit Nr.625 / D, Nr.625/10 Prot, datë 29.12.2020, me palë:

**Kreditor : Shoqëria "INA 2004" shpk.**

**Debitor : Shoqëria "FLORA CO" Shpk (FLORA KO).**

**Me objekt : Kthim Shume.**

Unë përmbaruesi gjyqësor Erzen Qeva, pasi shqyrtova materjalin e plotë të dosjes përmbarimore :

**KONSTATOVA :**

Në titullin ekzekutiv, Vendimi Nr. 8908, datë 21.10.2008, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë i ankimuar dhe lënë në fuqi me vendimin Nr.106, datë 26.01.2010 i Gjykatës së Apelit Tiranë, për të cilën është leshuar "Urdhëri i Ekzekutimit", vendimi Nr. 677 Akti, datë 24.03.2010 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, është vendosur detyrimi i debitorit Shoqëria "FLORA CO" Shpk (FLORA KO), me NIPT J61804014I, është i detyruar të paguajë kreditorit Shoqëria "INA 2004" shpk, shumën 59.545.94 (Pesëdhjet e nëntë mijë e pesëqind e dyzet e pesë euro e nëntëdhjet e katër cent) Euro dhe shumën 568.100 (Pesëqind e gjashtëdhjet e tetë mijë e njëqind) lekë.

Me vendim të Shoqërisë Përmbarimore Private "ALBASE" -sh.p.k, e Përmbaruesit Gjyqësor Privat Baftjar Nela, pasi nuk është përmbushur ekzekutimi vullnetarisht nga debitori, mbështetur në nenin 519 të K.Pr.Civile është kaluar në ekzekutim të detyrueshëm i titullit ekzekutiv dhe për rrjedhojë për ekzekutimin e Urdhërit të Ekzekutimit, në këto kushte në vazhdim të veprimeve përmbarimore kërkohet të vendoset masa e sekuestros në Aktivet e palës debitore Shoqëria "FLORA CO" Shpk (FLORA KO), me NIPT J61804014I, me Ortak i vetëm e Administrator

Z.Perlat Elezi, duke ndaluar tjetërsimin dhe/ose disponimin e tyre si dhe mos kryerjen e asnjë veprimi tjetër i cili mund të ndryshojë të dhënat e regjistrit tregtar deri në një urdhër të dytë nga ana e përmbaruesit gjyqësor.

**Për këtë arsye : Në bazë të neneve 527 e në vijim të K.Pr.Civile**

### **URDHËROJMË**

**1 - Vendosjen e masës së sekuestros konservative, mbi Aktivet, e palës debitore Shoqëria “Flora Ko” Shpk(FLORA CO), me NIPT J61804014I, me Ortak i vetëm e Administrator Z.Perlat Elezi, për shlyerjen e detyrimit në shumën 59.545.94 (Pesëdhjet e nëntë mijë e pesëqind e dyzet e pesë euro e nëntëdhjet e katër cent ) Euro dhe shumën 568.100 (Pesëqind e gjashtëdhjet e tetë mijë e njëqind) lekë, me adrese Rruga e Qelqit, Kombinat, Tiranë**

2-Mbi të drejtat që rrjedhin nga Aktivet duke ndaluar tjetërsimin dhe/ose disponimin e tyre si dhe mos kryerjen e asnjë veprimi tjetër i cili mund të ndryshojë të dhënat e regjistrit tregtar. Aktivet do të qendrojnë të bllokuar deri në një urdhër të dytë nga ana jonë.

3- Për veprimin apo mosveprimin tuaj,duhet të na vini në dijeni shkresërisht brenda afatit ligjor.

4- Për personat që bëhen pengesë në zbatimin e këtij urdhëri do të merren masat e parashikuara në neni 606 e në vijim të K.Pr.Civile, si dhe në rast se ka vënd do të kërkohet ndjekje penale në bazë të dispozitave të Kodit Penal.

5- Ky urdhër mbahet e ju njoftohet palëve të cilat në bazë të nenit 610 të K.Pr.C kanë të drejtën e ankimit në gjykatën e rrethit gjyqësor brenda 5 ditëve nga marja dieni.

**ZYRË E PËRMBARIMIT PRIVAT “QEVA”- SH.P.K**

**PËRMBARUESI GJYQËSOR PRIVAT**

**Erzen QEVA**

